

AASF mbështetet nga BERZH dhe Qeveria e Shqipërisë



STUDIM PËR SEKTORIN E VAJIT TË ULLIRIT

Ky studim informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e sektorit të vajit të ullirit, mbi mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor.

STUDIM PËR SEKTORIN E VAJIT TË ULLIRIT

Përgatitur nga:

Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF)

Prof. Dr. Engjëll Skreli / Prof. Assoc. Dr. Drini Imami

Instituti i Studimeve Ekonomike dhe Transferimit të Njohurive

Tiranë, 2019

AASF Project Office
Rr. Andon Zako Çajupi, No. 7
Tiranë, Albania
Tel: +355 69 294 1513
www.aasf.com.al
Info@aasf.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
1.HYRJE	7
2. METODOLOGJIA.....	9
3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË ULLIRIT.....	11
3.1. TENDENCAT E PRODHIMIT	11
3.2. TENDENCAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE.....	13
3.3. TREGU.....	14
4. STRUKTURA E ZINXHIRIT TË VLERËS DHE AKTORËT KYESORË	18
4.1. STRUKTURA E ZINXHIRIT TË VLERËS DHE PROFILI I AKTORËVE	18
4.2. FLUKSI I ZINXHIRIT TË VLERËS (ZV) DHE KOORDINIMI I KËTIJ ZINXHIRI	20
5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT	22
6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM.....	23
6.1. STRATEGJIA BAZUAR NË ANALIZËN SWOT	23
6.2. NEVOJAT PËR FINANCIM	24
7. PËRFUNDIME.....	27
8. BIBLIOGRAFIA	29
9. SHTOJCAT.....	30

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Konsumi i vajit të ullirit për frymë në BE (kg).....	15
Figura 2: Konsumi i dukshëm i vajit të ullirit në Shqipëri, Evropë dhe në botë (kg/frymë).....	16
Figura 3: Harta e zinxhirit të vlerës së vajit të ullirit.....	18

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Tendencat e kultivimit të ullirit në botë (000 tonë).....	11
Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të ullirit për vaj ulliri, sipas qarkut.....	11
Tabela 3: Shpërndarja e prodhimit të ullinjve për tavolinë, sipas qarkut.....	12
Tabela 4: Bilanci i prodhimit të vajit të ullirit (tonë).....	12
Tabela 5: Tendencat e prodhimit të vajit të ullirit në botë (000 tonë).....	13
Tabela 6: Tregtia ndërkombëtare e vajit të ullirit	13
Tabela 7: Përbërja e importeve të vajit të ullirit (2016).....	13
Tabela 8: Fermat e ullirit me orientim tregu (6 dn e lart) për vitin 2017 (dynym).....	19
Kutia 1: Koordinimi i zinxhirit të vlerës - rasti i certifikimit organik.....	21
Tabela 9: Kalendar i kostove kryesore që lidhen me prodhimin e ullirit	22
Tabela 10: Kalendar i prodhimit të ullirit sipas qarkut.....	22
Tabela 11: Nevojat e financimit për investime	24
Kutia 2: Skemat publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare.....	25
Tabela 12: Shpërndarja e fermave të mëdha sipas qarkut.....	30
Tabela 13: Tendencat e kultivimit të ullirit në botë (000 ha).....	30
Tabela 14: Tendencat e prodhimit të ullirit në botë (tonë/ha).....	30
Tabela 15: Konsumi i vajit të ullirit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë).....	31
Tabela 16: Rajonalizimi i skemave kombëtare të subvencionimit (2018).....	32

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sektori i ullirit dhe vajit të ullirit është një nga sektorët kryesorë agroushqimorë në Shqipëri. Më shumë se 100 000 fermerë janë përfshirë në kultivimin e ullirit. Prodhimi i ullirit dhe vajit të ullirit në Shqipëri është rritur pjesërisht në sajë të skemave të subvencionimit nga qeveria. Megjithatë, dobësitë kronike të sektorit, d.m.th. rendimenti i ulët dhe çmimi i lartë i lëndëve të para nuk janë zgjidhur - importet mbeten në vlera të larta ndërsa eksportet janë shumë modeste. Zinxhiri i vajit të ullirit konsiderohet si sektor me përparësi po të merret parasysh zëvendësimi i importit të tij, por edhe eksporti i vajit të ullirit të cilësisë së lartë.

Prodhimi i ullirit është karakterizuar nga një trend rritës i dukshëm - pothuajse është trefishuar (në rreth 100 000 - 120 000 tonë gjatë 2 viteve të kaluara) krahasuar me fillimin e viteve 2000, por megjithatë ka luhatje të mëdha nga viti në vit. Edhe prodhimi i vajit të ullirit është rritur ndjeshëm, duke arritur në 20 000 tonë vitin e kaluar (2017) - duke qenë se shumica e ullinjve përdoren për vaj ulliri, rritja e prodhimit të vajit të ullirit ka ndjekur tendencën rritëse të prodhimit të ullinjve të papërpunuar. Prodhimi është ende shumë i fragmentizuar dhe rendimenti është mjaft i ulët, pasi fermerët nuk kryejnë shërbimet e duhura agronomike për pemët. Fragmentizimi i lartë dhe kostot e prodhimit nënkuptojnë se potenciali për eksport është shumë i kufizuar, të paktën për sa i përket konkurrencës në vëllim dhe çmim, duke pasur gjithashtu parasysh se vendet fqinje të Shqipërisë janë prodhues lider të ullirit dhe vajit të ullirit; megjithatë, ekziston potenciali për të eksportuar/shitur në segmentet që paguajnë më shumë.

Objekti i këtij raporti studimi është të japë një panoramë të përgjithshme të sektorit të ullirit dhe vajit të ullirit në Shqipëri, duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime. Ky raport studimor ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes për institucionet financiare ose për përgatitjen e shërbimeve financiare. Por përdorues potencialë të gjetjeve dhe rekomandimeve të këtij studimi mund të jenë edhe institucionet shtetërore, shoqatat e biznesit, agjencitë e zhvillimit, akademikët dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Ky studim është përgatitur nga ekspertët e Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF), i cili është një program i financuar dhe zhvilluar nga BERZH (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në bashkëpunim dhe me mbështetje nga qeveria shqiptare, i cili ka nisur aktivitetin në vitin 2016.

Qëllimi i këtij Programi është të motivojë institucionet financiare shqiptare për të mbështetur një sektor vital të ekonomisë shqiptare me potenciale gjerësisht të pashfrytëzuara - bujqësia dhe agrobizneset. AASF siguron qasje në financa për sektorin e agrobiznesit në dy mënyra: Linjë kredish dhe/ose shpërndarjen e riskut të portofolit për institucionet mikrofinanciare (IMF) dhe bankat. Institucionet përfitojnë nga një mbulim i parë i rrezikut të humbjeve që u vihet në dispozicion nga Qeveria Shqiptare. AASF përfaqëson një instrument inovativ financiar për të inkurajuar kreditimin nga institucionet financiare në të gjithë zinxhirin e vlerës së agrobiznesit.

Përfituesit përfundimtarë të AASF janë fermerët, sipërmarrësit dhe kompanitë që janë të angazhuar në bujqësinë primare, prodhimin dhe tregtinë e pajisjeve bujqësore, logjistikën, ofruesit e shërbimeve të agrobiznesit, përpunimin bujqësor, tregtarët me pakicë si dhe shitësit me pakicë. Agrobizneset mund të përfitojnë gjithashtu nga programi i Këshillimit të BERZH-it për Biznesin e

Vogël (ASB), i cili ofron konsulentë për zhvillimin e strategjisë, marketingut, ristrukturimin teknik dhe fushat tjera të zhvillimit institucional nga ekspertët ndërkombëtarë dhe lokalë.

Për të përmbushur objektivat e studimit janë përdorur burimet dytësore dhe parësore të të dhënave; intervistat pjesërisht të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit, strategjia bazuar në analizën SWOT. Kombinimi i analizës cilësore dhe sasore ka qenë thelbësor për të identifikuar/kuptuar tendencat, boshllëqet dhe nevojat për investime.

Nga ky studim rezulton se nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar teknologjinë bujqësore (për plantacionet e reja dhe ullishtat ekzistuese) në mënyrë që Shqipëria të konkurrojë me anë të kostos së ulët importet e vajit të ullirit nga vendet mesdhetare. Kështu që ekzistojnë mundësitë për të financuar plantacionet e reja dhe për të rindërtuar plantacionet e ullishtave ekzistuese. Ndërkohë që ka pasur investime shumë të mëdha në sektorin e përpunimit të vajit të ullirit, ekziston nevoja për të mbështetur rinovimin e teknologjisë për një pjesë të konsiderueshme të punishteve të përpunimit (që po vjetërohen dhe po dalin jashtë funksionit). Rekomandohet që përparësia në investime të jetë në rinovimin e teknologjisë së kompanive ekzistuese me përvojë në vend të investimeve për krijimin e bizneseve të reja. Investimet në ndërtimin e fabrikave të reja të vajit të ullirit duhet të shqyrtohen me kujdes, duke pasur parasysh faktin që shumica e njësive përpunuese të vajit të ullirit shfrytëzohen shumë më pak se kapaciteti i tyre. Duke qenë se mungon kapaciteti i duhur për magazinimin e vajit të ullirit, përpunuesit raportojnë nevojën për të krijuar kapacitetin e magazinimit për të gjithë industrinë e vajit të ullirit (ku përfshihen shumica e përpunuesve të vajit të ullirit). Investimi në kapacitetet magazinuese të vajit të ullirit është një faktor kryesor që ndikon në cilësinë e vajit të ullirit, së bashku me cilësinë e frutit, teknologjinë e përpunimit dhe njohuritë teknike. Kapaciteti i ambalazhimit në shishe, i etiketimit dhe paketimit në fabrikat e vajit dhe përpunuesit industrialë përbën gjithashtu një mundësi për institucionet financiare dhe mbështetje nga qeveria, duke qenë se vetëm pak fabrika vaji i kanë këto pajisje. Dy projekte kryesore të lidhura me industrinë e përpunimit të mbetjeve nga sektori i ullirit mund të merren gjithashtu në konsideratë, dhe më konkretisht, projekti për rafinimin e vajit të ullirit dhe projekti për përpunimin e mbetjeve nga vaji i ullirit. Duke qenë se këto janë projekte të mëdha, këshillohet që çdo vendim financiar të paraprihet nga studime të qëndrueshme fizibiliteti.

Natyra e dyfishtë e sektorit të vajit të ullirit - prodhimi i një vaji ulliri të një cilësie të denjë dhe me çmim konkurrues të synuar për konsum të brendshëm, nga njëra anë, dhe prodhimi i një vaji ulliri me cilësi të lartë dhe me çmim të lartë duke synuar eksportin, nga ana tjetër, nënkupton një qasje të dyfishtë për institucionet financiare. Opsioni i parë do të ishte mbështetja e investimeve për të rritur efikasitetin dhe për të ulur koston, dhe opsioni i dytë do të ishte mbështetja për rritjen e cilësisë kombinuar me certifikimin. Mbështetja për këtë sektor duhet të merret në konsideratë në ndërthurje me mbështetjen publike. Zinxhiri i vlerës i ullirit konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare bazuar në potencialin e tij për eksport - sektori është përfshirë në të gjitha skemat e mbështetjes financiare publike, duke përfshirë skemat e fundit të mbështetjes.

1. HYRJE

Historiku

Bujqësia është një nga sektorët kryesorë të ekonomisë shqiptare për sa i përket punësimit dhe kontributit në PBB dhe konsiderohet si sektor me përparësi nga qeveria shqiptare. Pavarësisht rritjes gjatë kohëve të fundit, bujqësia shqiptare ende përballet me sfida të ndryshme, duke përfshirë vështirësinë në aksesin në kredi; sektori bujqësor ka tërhequr vetëm 2% të totalit të kreditimit të ekonomisë.

Prodhimi i ullirit pothuajse është trefishuar (në rreth 100 000 - 120 000 tonë gjatë 2 viteve të kaluara) krahasuar me fillimin e viteve 2000, por megjithatë, ka luhataje të mëdha nga viti në vit. Edhe prodhimi i vajit të ullirit është rritur ndjeshëm, duke arritur në 20 000 tonë vitin e kaluar (2017) - duke qenë se shumica e ullinjve përdoren për vaj ulliri, rritja e prodhimit të vajit të ullirit ka ndjekur tendencën rritëse të prodhimit të ullinjve të papërpunuar. Prodhimi është ende shumë i fragmentizuar dhe rendimenti është mjaft i ulët, pasi fermerët nuk kryejnë shërbimet e duhura agronomike për pemët. Fragmentizimi i lartë dhe kostot e prodhimit nënkuptojnë se potenciali për eksport është shumë i kufizuar, të paktën për sa i përket konkurrencës në vëllim dhe çmim, duke pasur gjithashtu parasysh se vendet fqinje të Shqipërisë janë prodhues lider të ullirit dhe vajit të ullirit; megjithatë, ekziston potenciali për të eksportuar/shitur në segmentet që paguajnë më shumë. Ndërkohë që industria përpunuese e vajit të ullirit karakterizohet nga investime shumë të mëdha në teknologji bashkëkohore, ekspertët sugjerojnë se ekziston nevoja për rinovim. Industria e përpunimit të vajit të ullirit është më tepër një industri që u shërben të tjerëve - fabrikat përpunojnë ullinjtë për llogari të fermerëve. Kjo është një nga arsyet kryesore se përse organizimi i këtij zinxhiri është shumë i dobët.

Objektivat e studimit

Objektivi i përgjithshëm i këtij studimi është që të japë një panoramë të përgjithshme të zinxhirit të përzgjedhur të vlerës në Shqipëri duke analizuar zhvillimet e fundit dhe gjendjen aktuale, dhe duke përfshirë mundësitë, kufizimet dhe vështirësitë, me fokus të veçantë në nevojat/potencialet për investime.

Në mënyrë më specifike, studimi: (i) ofron një panoramë të përgjithshme të prirjeve kryesore të prodhimit, tendencave ndërkombëtare të tregtisë dhe të tendencave të tregut; (ii) -ofron një analizë specifike të strukturës së zinxhirit të vlerës, të flukseve dhe administrimit të zinxhirit të vlerës, me fokus të veçantë të "liderët në zinxhirin e vlerës"; (iii) analizon pikat kryesore të zinxhirit të vlerës nëpërmjet një strategjie për analizën SWOT, dhe (iv) rekomandon mundësinë kryesore për sistemin bankar (financim për investime, financim për kapital qarkullues dhe financim të zinxhirit të vlerës).

Ky raport studimor ofron informacione dhe rekomandime që mund të jenë të dobishme për të orientuar strategjitë e hyrjes për institucionet financiare ose për përgatitjen e paketave financiare.

Metodologjia

Për të përmbushur objektivat e studimit janë përdorur burimet dytësore dhe parësore të informacionit/të dhënave; intervistat pjesërisht të strukturuar me aktorë të zinxhirit të vlerës dhe ekspertë të sektorit janë përdorur si burim parësor për mbledhjen e të dhënave. Të dhënat janë analizuar duke përdorur teknika të ndryshme, ku përfshihen analiza përshkruese, analiza e trendeve (dinamike), analiza e tekstit, strategjia bazuar në analizën SWOT. Analiza e zinxhirit të vlerës është miratuar si kornizë e përgjithshme për analizën. Metodologjia përshkruhet më në detaje në seksionin në vijim.

Përdoruesit e synuar

Studimi për zinxhirin e vlerës është hartuar kryesisht për institucionet financiare, por ky raport studimor mund të shërbejë si mbështetje e dobishme në procesin vendimmarrës të aktorëve të tjerë përkatës, si Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), agjencitë e zhvillimit dhe aktorët e sektorit privat (p.sh. firmat, shoqatat).

Çfarë është dhe çfarë nuk është ky studim

Raporti **nuk** është një vlerësim specifik që trajton nevojën e potencialit prodhues dhe eksportues duke e lidhur me domosdshmerinë e financimit të tij. Studimi është projektuar për të shërbyer si "instrument" për stafin ekzekutiv (të bankave) dhe jo si studim kërkimor në vetvete.

Raporti **është** një studim specifik identifikues që analizon në detaje çdo ndërhyrje në zinxhirin e vlerës, aktorëve kryesorë dhe ato indirekt, të shërbimeve mbështetëse (shërbimet e biznesit, shërbimet bankare dhe shërbime të tjera ose shërbime të integruara) dhe mjedisin ekonomik global, kombëtar dhe lokal.

Struktura e raportit

Pas përzgjedhjes së potencialeve prodhuese si seksion i parë, raporti është strukturuar si më poshtë: seksioni i dytë përmban përshkrimin e metodologjisë. Seksioni i tretë paraqet një analizë të gjerë të tendencave të prodhimit dhe të tregtisë ndërkombëtare. Seksioni katër përshkruan strukturën e zinxhirit të vlerës, flukset dhe profilin e aktorëve. Seksioni pesë jep një panoramë të përgjithshme të proceseve të teknologjisë së prodhimit për ta njohur lexuesin me proceset kryesore teknologjike dhe kostot përkatëse, duke theksuar kohën kur kryhen këto procese/kosto, si dhe vjeljen/prodhimin (variabël për kohën e shitjeve). Seksioni gjashtë paraqet analizën SWOT që fokusohet në nevojat/potencialët për investime, ndërsa seksioni i fundit përmban përfundimet.

2. METODOLOGJIA

Përzgjedhja e sektorit

Studimi për zinxhirin e vlerës së vajit të ullirit është pjesë e një "pakete studimesh sektoriale" për të gjithë sektorët më të rëndësishëm të bujqësisë shqiptare. Për këtë arsye, faza e parë ka konsistuar në përcaktimin e përparësisë së sektorëve ose nënsektorëve apo (grupeve të) produkteve për të cilat ekziston kërkesa/potenciali më i lartë për rritje dhe investime - duke marrë në konsideratë potencialin e tregut për eksport ose potencialin për zëvendësimin e importeve. Dy grupe faktorësh janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të listës së produkteve që do të analizoheshin, përkatësisht potenciali i tregut dhe faktorët e tjerë që mundësojnë avantazhe konkurruese të produktit. Potenciali i tregut është shqyrtuar nga dy këndvështrime: potenciali për eksport dhe potencialet për zëvendësimin e importeve. Potenciali për eksport merr në konsideratë performancën e njohur të eksporteve të kombinuar me kërkesën ndërkombëtare për një produkt të caktuar - kur eksportet rriten me kalimin e kohës dhe kjo përkon me rritjen e kërkesës ndërkombëtare, konsiderohet se ky produkt ka potenciale për eksport. Potencialet për zëvendësimin e importeve shqyrtojnë potencialet për të përmbushur kërkesën vendase. Konsiderime të tjera që çojnë në një avantazh konkurrues përfshijnë faktorin e anës së ofertës, si raporti krahasues pune-tokë, tradita dhe aftësitë, si dhe lidhjet e vendosura ndërmjet aktorëve në zinxhirin e vlerës, duke përfshirë gjithashtu lidhjet shumë të mira ndërmjet aktorëve shqiptarë dhe blerësve ndërkombëtarë.

Zinxhiri i vlerës i vajit të ullirit konsiderohet si sektor me përparësi po të merret parasysh zëvendësimi i importit të tij, por edhe eksporti i vajit të ullirit i cilësisë së lartë.

Mbledhja e të dhënave

Ky studim është pjesërisht cilësor dhe pjesërisht sasior. Kjo mundëson që të kuptohet më mirë statusi dhe dinamikat e zinxhirit të produktit përkatës. Studimi kombinon analizën e të dhënave dytësore dhe parësore të mbledhura. Për çështje/tregues të ndryshëm, analiza është bazuar në të dhënat dytësore (duke përfshirë të dhënat sektoriale/strukture).

Të dhënat dytësore janë marrë nga MBZHR (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), INSTAT (Instituti i Statistikave), UNSTAT COMTRADE (për tregtinë ndërkombëtare), FAOSTAT (për prodhimin dhe konsumin) dhe EUROSTAT (për prodhimin dhe tregtinë ndërkombëtare) etj. Gjithashtu, është kryer një shqyrtim i studimeve dhe raporteve të tjera. Kufizimet e hasura janë se për disa tregues (lidhur me prodhimin vendas dhe tregtinë e brendshme) nuk ka statistika të disponueshme, ndërsa për disa të tjera nuk ka statistika të kohëve të fundit. Megjithatë, për tregtinë ndërkombëtare janë gjetur të dhënat më të fundit që edhe janë analizuar. Ndërkohë, në ato raste kur ka qenë e nevojshme dhe e mundur, janë mbledhur të dhëna nga vende ose të dhëna rajonale të tjera për qëllimet e një analize krahasuese. Fokusi i këtij raporti për zinxhirin e vlerës është te vaji i ullirit, por jepen informacione edhe për ullinjtë për tavolinë, kur nevojitet.

Mbledhja e të dhënave parësore është realizuar nga intervistat e thëlluara me informuesit kyç që përfaqësonin aktorë të zinxhirit të vlerës dhe me ekspertë të sektorit. Për të identifikuar aktorët dhe ekspertët kryesorë për çdo zinxhir vlere për intervistat (pjesë e studimit cilësor parësor) u përdor një anketim me teknikë kampionimi "snowball" (ortek bore). Intervistat e thëlluara me

aktorët kyçë të informuar (së bashku me studimet e dokumentacionit në dispozicion) mundësuan përfitim e një perceptimi të përditësuar për modelet kryesore të sektorëve kyçë.

Analiza e të dhënave

Në lidhje me analizën e të dhënave/informacioneve, të dhënat statistikore dytësore i janë nënshtruar një analize standarde përshkruese, duke përfshirë tabelat dhe grafikët që tregojnë trendet statistikore apo historike. Është kryer edhe krahasimi i trendeve të prodhimit dhe konsumit me ato në botë, në Evropë dhe në disa raste me vendet fqinje, kur kjo ishte e nevojshme. Për sa i përket intervistave me ekspertë/aktorë të ZV-së, shënimet janë analizuar duke përdorur teknikat e analizës cilësore, me qëllimin për të përmbledhur çështjet më të rëndësishme dhe më interesante të përmendura në intervista. Analiza e zinxhirit të vlerës është përdorur si kuadër i përgjithshëm për analizën e strukturës së zinxhirit të vlerës (produktet, financat dhe informacionet) dhe për analizën e flukseve.

3. TENDENCAT DHE PRESPEKTIVAT E SEKTORIT TË ULLIRIT

3.1. TENDENCAT E PRODHIMIT

3.1.1. Prodhimi parësor

Sektori i ullirit dhe vajit të ullirit është një nga sektorët kryesorë agrorshqimorë në Shqipëri. Më shumë se 100 000 fermerë janë përfshirë në kultivimin e ullirit. Kultivimi i ullirit në Shqipëri është rritur, veçanërisht në fund të viteve 2000 dhe në fillim të viteve 2010, pjesërisht i nxitur edhe nga skemat e subvencionimit nga qeveria - prodhimi parësor i ullirit ka qenë përfitues i skemës më të madhe të mbështetjes (kombëtare) nga qeveria. Megjithatë, dobësitë kronike të sektorit, d.m.th. rendimenti i ulët dhe çmimi i lartë i lëndëve të para ende nuk janë zgjidhur.

Prodhimi i ullirit në Shqipëri është rritur më shpejt se sa trendet e prodhimit në botë. Prodhimi i ullirit pothuajse është trefishuar (në rreth 100 000 tonë në vitin 2016) krahasuar me fillimin e viteve 2000, por megjithatë, ka luhajtje të mëdha nga viti në vit.

Tabela 1: Tendencat e kultivimit të ullirit në botë (000 tonë)

Shteti	2000	2005	2010	2014	2015	2016
Shqipëri	36	30	70	98	96	99
Mali i Zi	:	:	0	0	0	0
BE	10,496	10,714	13,460	9,612	11,161	11,687
Bota	15,654	15,965	20,418	16,209	19,341	19,267
Evropë	10,528	10,743	13,527	9,705	11,256	11,785
Evropa Jugore	10,512	10,721	13,496	9,692	11,222	11,758

Burimi: FAOSTAT

Rajonalizimi

Prodhimi i ullirit për vaj ulliri është mjaft i përqendruar në qarqet e Fierit, Vlorës dhe Elbasanit, të cilët së bashku përbëjnë 3/4 e prodhimit total. Në këto qarqe ka edhe një përqendrim të madh të fabrikave/përpunuesve të vajit të ullirit.

Tabela 2: Shpërndarja e prodhimit të ullirit për vaj ulliri, sipas qarkut

Qarku	Tonë	Përqindja	Kumulative
Fier	28,702	37%	37,1%
Vlorë	13,768	18%	54,9%
Elbasan	13,547	17%	72,4%
Berat	7,409	10%	81,9%
Tiranë	5,016	6%	88,4%
Durrës	4,375	6%	94,1%
Lezhë	2,197	3%	96,9%
Gjirokastër	1,816	2%	99,2%
Shkodër	588	1%	100,0%
Totali	77,419	100%	

Burimi: INSTAT (2017)

Prodhimi i ullinjve për tavolinë është mjaft i përqendruar në qarkun e Beratit, i cili prodhon më shumë se 2/3 e totalit të prodhimit vendas. Në Berat ndodhen edhe disa sipërmarrje që janë angazhuar në përpunimin e ullinjve për tavolinë (p.sh. ullinjtë e konservuar të tavolinës).

Tabela 3: Shpërndarja e prodhimit të ullinjve për tavolinë, sipas qarkut

Qarku	Tonë	Përqindja	Kumulative
Berat	15,241	70%	70,4%
Fier	2,590	12%	82,3%
Elbasan	1,555	7%	89,5%
Gjirokastrë	628	3%	92,4%
Tiranë	493	2%	94,7%
Shkodër	485	2%	96,9%
Vlorë	282	1%	98,2%
Durrës	199	1%	99,2%
Lezhë	184	1%	100,0%
Totali	21,656	100%	

Burimi: INSTAT (2017)

3.1.2. Përpunimi

Prodhimi i vajit të ullirit është rritur ndjeshëm duke arritur në 20 000 tonë në vitin 2017 – duke qenë se shumica e ullinjve përdoren për vaj ulliri, rritja e prodhimit të vajit të ullirit është e nxitur nga rritja e prodhimit të ullinjve të papërpunuar. *Pavarësisht rritjes së prodhimit të ullirit, ka një tepricë kapacitetesh përpunuese (shumica e njësisve të përpunimit nuk shfrytëzohen në kapacitetin e tyre të plotë).* Ky është edhe mendimi i përpunuesve të intervistuar – ekzistenca e mbikapaciteteve në përpunim nënkupton se investimet në njësi të reja përpunimi nuk do të ishin rentabël.

Tabela 4: Bilanci i prodhimit të vajit të ullirit (tonë)

Kategoria	2000	2005	2010	2011	2012	2013	2014	2017
Prodhimi	1,875	3,454	7,816	6,939	13,745	10,996	8,900	20,000*
Eksporte	38	2	15	19	11	16	0	10*
Importe	666	904	1,378	1,354	1,512	1,077	987	802
Oferta e brendshme total	2,503	4,356	9,178	8,274	15,246	12,057	9,887	20,792
Raporti import/ofertë	26,60%	20,75%	15,01%	16,37%	9,92%	8,93%	9,98%	4,01%

* Burimi i vlerësimeve: INSTAT (Prodhimi), UNSTAT (Tregtia)

Pavarësisht rritjes së kohëve të fundit, prodhimi i vajit të ullirit në Shqipëri është i papërfillshëm krahasuar me prodhimin evropian (që dominohet nga Italia, Greqia (vende fqinje me Shqipërinë) dhe Spanja).

Tabela 5: Tendencat e prodhimit të vajit të ullirit në botë (000 tonë)

Shteti	2000	2005	2010	2014	2017
Shqipëri	2	4	8		20*
BE	1,913	1,921	2,308	2,317	:
Bota	2,523	2,569	3,169	3,050	2,854*
Evropë	1,911	1,923	2,308	2,317	:
Evropa Jugore	1,908	1,918	2,302	2,312	:

Burimi: FAOSTAT (2018) dhe Vjetari statistikor i MBUMK (2010); * Parashikime

3.2. TENDENCAT E TREGTISË NDËRKOMBËTARE

Importet shqiptare të vajit të ullirit janë rritur përgjatë viteve, me më shumë se 4 herë që nga viti 2000, duke arritur në 5,5 milionë Euro. Ndërkohë, eksportet janë të ulëta – performanca më e mirë u arrit në vitin 2016, kur eksportet ishin 149 200 USD, por mbeten sërish 33 herë më të ulëta se importet.

Tabela 6: Tregtia ndërkombëtare e vajit të ullirit

Viti	Eksporti		Importi		Balanci	
	Tonë	000 USD	Tonë	000 USD	Vlera	Sasia
2000	27.5	43.8	663.6	1256.8	4.1%	3.5%
2005	1.6	13.6	815.4	3877.6	0.2%	0.3%
2010	15.3	79.4	1201.3	3814.0	1.3%	2.1%
2013	16.2	91.0	976.8	3669.3	1.7%	2.5%
2015	2.1	8.5	1277.3	5112.7	0.2%	0.2%
2016	41.1	149.2	1378.8	5500.0	3.0%	2.7%

Burimi: UNSTAT (2018)

Shumica e importeve vijnë nga Italia - pothuajse 2/3.

Tabela 7: Përbërja e importeve të vajit të ullirit (2016)

Shteti	000 USD	Tonë	Përqindja (tonë)	USD/kg
Totali	5500	1379	100	4.0
Itali	3284	877	64	3.7
Greqi	1567	323	23	4.9
Spanjë	649	179	13	3.6

Burimi: UNSTAT (2018)

3.3. TREGU

3.3.1. Tregu ndërkombëtar

Tendencat në BE ¹

Prodhimi botëror i vajit të ullirit dominohet nga BE-ja (e cila zë më shumë se 2/3 e prodhimit botëror të vajit të ullirit dhe është furnizuesi kryesor i eksporteve globale). Prodhimi i BE-së dominohet nga katër shtete prodhuese kryesore: Spanja, Italia, Greqia dhe Portugalia (këto vende përbëjnë së bashku 99% të prodhimit të BE-së) – kështu, dy nga katër prodhuesit lider në BE (dhe në botë) janë vende fqinje të Shqipërisë, duke e ekspozuar Shqipërinë ndaj konkurrencës së fortë e të drejtpërdrejtë (si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në përpjekjet e ardhshme për eksport drejt tregjeve evropiane).


Vitet e fundit prodhimi i vajit të ullirit në BE është karakterizuar nga luhatje të mëdha, pavarësisht investimeve të konsiderueshme në sistemet e prodhimit me ujitje. Për shembull, në periudhën 2016/2017 prodhimi ra me 1/4 për shkak të kushteve jo të favorshme klimatike dhe dëmtimit të ullishtave nga *sëmundjet*.

Sektori i vajit të ullirit në BE parashikon përmirësime strukturore të mëtejshme përgjatë periudhës së parashikuar, si p.sh. konvertimi i prodhimit në sisteme prodhimi më produktive, në veçanti: (i) rritja e sipërfaqeve të ujitura; dhe (ii) zgjerimi i sipërfaqeve të prodhimit duke zëvendësuar kultura të tjera bujqësore në rajonet tradicionale prodhuese.

Parashikohet që deri në vitin 2030 prodhimi në BE të rritet me 1/3 krahasuar me periudhën 2014-2016. Zhvillimi i mëtejshëm i plantacioneve intensive të ullinjve dhe me ujitje mund të zbutë luhatjet në prodhim. Megjithatë, qëndrueshmëria ekonomike e ullishtave tradicionale do të hasë vështirësi gjatë viteve me prodhim të bollshëm, kur të ketë ulje të çmimit. Kjo ndodh për shkak të rendimentit më të ulët dhe kostove më të larta të prodhimit të ullishtave tradicionale. Kështu që nevoja e këtyre sistemeve për të krijuar vlera, veçanërisht duke përdorur etiketat e cilësisë si treguesit gjeografikë (TGJ) dhe etiketat organike do të bëhet më dominuese – ky zhvillim është shumë i rëndësishëm për prodhimin shqiptar, i cili është shumë i shpërndarë (dhe nuk mund të konkurrojë me kosto prodhimin masiv të ullishtave në BE).

Konsumi në BE është karakterizuar nga një ulje e rregullt në katër shtetet anëtare prodhuese kryesore, me një rënie më të shpejtë, deri në 8,5 kg për frymë në vitin 2016, gjatë krizës financiare dhe gjatë kohëve të fundit për shkak të çmimeve shumë të larta. Deri në vitin 2030 është parashikuar një rënie e mëtejshme e konsumit total në këto vende. Konsumi në rritje në pjesën tjetër të BE-së do të kompensonte këtë rënie; por megjithatë konsumi për frymë mbetet në një nivel të ulët.

1 Ky seksion bazohet pjesërisht te "EC (2017), EU Agricultural Outlook for the Agricultural Markets and Income 2017-2030"


Figura 1: Konsumi i vajit të ullirit për frymë në BE (kg)

Burimi: EC (2017)

Si përmbledhje, Shqipëria ka avantazhe konkurruese të kufizuara në eksportin e vajit të ullirit për shkak të kostos së lartë të prodhimit, vëllimeve të ulëta dhe standardeve të diskutueshme të cilësisë dhe sasisë. Ndërkohë që pak kompani tregtare kanë arritur të gjejnë tregun "niche" të tyre dhe të eksportojnë me cilësi të lartë, aktorët kryesorë të industrisë së vajit të ullirit në Shqipëri duhet të kenë si objektiv tregun e brendshëm, ku ka mundësi të konsiderueshme për të plotësuar kërkesën në rritje dhe ende të paplotësuar.

3.3.2. Tregu i brendshëm

Konsumi i vajit të ullirit në Shqipëri ka rënë shumë gjatë fillimit të tranzicionit. Një arsye është ulja e prodhimit të brendshëm (të ullirit dhe vajit të ullirit) duke qenë se një pjesë e madhe plantacioneve me ullinj/ullishta u dëmtuan rëndë gjatë tranzicionit. Konsumi i dukshëm i vajit të ullirit në Shqipëri - i cili sipas statistikave të FAOSTAT është më pak se 1 litër/për frymë - është më i lartë se konsumi mesatar global për frymë, megjithatë, shumë më i ulët krahasuar me Evropën Jugore, gjë që tregon potencialin e madh për të rritur konsumin. Megjithatë, një faktor që qëndron pas këtij hendeku mund të jetë mosraportimi i vajit të ullirit të prodhuar në rrugë informale, e cila është forma kryesore e përpunimit të vajit të ullirit. Sipas vlerësimeve (10 000 deri në 20 000 tonë vaj ulliri të prodhuar në vit, duke pasur parasysh popullsinë), konsumi i vajit të ullirit mund të jetë afërsisht 5 litra/për frymë - kështu që sipas këtyre vlerësimeve, konsumi duhet të jetë më i lartë se statistikave të FAOSTAT por sërish më i ulët krahasuar me tendencat e konsumit në BE - për rrjedhojë, ekziston hapësira/potenciali që konsumi i brendshëm (kërkesa) të rritet gjatë viteve në vazhdim (me një rritje të mëtejshme të të ardhurave dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit). Greqia mban rekordin më të lartë të konsumit të vajit të ullirit, rreth 23 litra për frymë.

Figura 2: Konsumi i dukshëm i vajit të ullirit në Shqipëri, Evropë dhe në botë (kg/frëmë)

Burimi: FAOSTAT (2018)

Origjina e prodhimit duket se është një faktor i rëndësishëm për shumicën e konsumatorëve shqiptarë. Sipas studimeve të ndryshme, shumica e konsumatorëve i zgjedhin produktet e tyre nga origjina (vendase kundrejt importeve). Përgjithësisht, ka një preferencë të madhe të konsumatorëve për produktet ushqimore vendase. Gjithashtu, brenda grupit të produkteve vendase, ka dallime të konsiderueshme në perceptimet brenda Shqipërisë bazuar në rajonin e prodhimit. Shumica e konsumatorëve e konsiderojnë rajonin/zonën e origjinës si të rëndësishme ose si shumë të rëndësishme kur vendosin të blejnë produkte shqiptare. Kushtet natyrore dhe materiali gjenetik mund të perceptohen se lidhen me origjinën e produkteve të preferuara rajonale².

Një studim i mëparshëm³ ka konstatuar një preferencë të lartë të konsumatorëve në Shqipëri për vajin e ullirit të vendit – origjina është faktor kyç zgjedhjeje për 3 nga 6 segmente të konsumatorëve, të cilët të gjithë së bashku përbëjnë 4/5 e konsumatorëve – konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë më shumë për vajin e ullirit të vendit. Çmimet e larta konsiderohen si një prej pak garancive të cilësisë. Sipas një studimi tjetër, shumica e konsumatorëve preferojnë vajin e ullirit nga qarku i Beratit dhe i Vlorës. Berati është gjithashtu prodhuesi kryesor i ullinjve për tavolinë në Shqipëri – kështu që vaji i ullirit dhe ullinjte për tavolinë nga Berati paraqesin potencial për zhvillimin e tregut. Një shumicë e qartë e të intervistuarve janë të gatshëm të paguajnë një çmim më të lartë për vajin e ullirit nga origjina e preferuar. Prodhimi i vajit të ullirit ka një traditë të fortë dhe histori të gjatë në këto treva, kështu që ka potencial për të zhvilluar marka rajonale, duke

2 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

3 Chan-Halbrendt, C., Zhllima, E., Sisor, G., Imami, D., & Leonetti, L. (2010). Consumer preferences for olive oil in Tirana, Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 13(3).

përfshirë TGJ-të ose EOM-të⁴.

Shumica e konsumatorëve shqiptarë i konsiderojnë produktet organike si më të sigurta dhe më të shëndetshme se produktet e tjera (tradicionale). Megjithatë, shumica e konsumatorëve nuk kanë njohuri për certifikimin organik (kërkesat). Konsumatorët shqiptarë kanë një mungesë të përgjithshme informacioni për atë çka quhet ushqim organik⁵. Tregu për ushqimin organik në Shqipëri është ende i vogël, por preferenca e konsumatorëve për ushqim organik paraqet një potencial për zhvillimin e tregut në përgjithësi dhe për vajin e ullirit në veçanti, i cili mund të zhvillohet në të ardhmen me rritjen e të ardhurave dhe ndërgjegjësimin rreth ushqimeve organike (vajin e ullirit).

Zhvillimi i Treguesve Gjeografikë (TGJ) dhe certifikimi organik mund të nxisë kërkesën për investime të reja.

4 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.


5 Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., & Chan, C. (2017). Consumer attitudes towards organic food in the Western Balkans- the case of Albania. *ECONOMIA AGRO-ALIMENTARE*.
Leoneti, L., Imami, D., Stafanllari, A., and Zhllima, E. (2009). The olive and olive oil value chain in Albania. Development Solutions Associates. 2009

4. STRUKTURA E ZINXHIMIT TË VLERËS DHE AKTORËT KYESORË

4.1. STRUKTURA E ZINXHIMIT TË VLERËS DHE PROFILI I AKTORËVE

Figura 3 identifikon në hartë aktorët e zinxhirit të vlerës së vajit të ullirit dhe kanalet kryesore përmes së cilëve qarkullojnë ullinjtë nga fermerët te konsumatori fundor.

Figura 3: Skema e zinxhirit të vlerës së vajit të ullirit



Burimi: Krijim i vetë autorëve

Dy aktorët kryesorë në zinxhirin e vlerës së vajit të ullirit janë fermerët dhe përpunuesit e vajit të ullirit. Shumica e fermerëve janë fermerë të vegjël (më pak se 0,5 ha ullishte/plantacion me ullinj). Përpunuesit mund të kategorizohen në përpunues të vegjël lokalë (ofrues shërbimi), përpunues të mesëm, përpunues industrialë (ambalazhuesit në shishe) dhe përpunues të vegjël modernë. Dy kategoritë e fundit gjithashtu eksportojnë vaj ulliri të cilësisë së lartë. Në diskutimin e mëposhtëm përshkruhet më me hollësi profili i aktorëve, dhe që pasohet nga flukset e zinxhirit të vlerës dhe administrimi i këtij zinxhiri.

Fermerët

Vlerësohet se më shumë se 100 000 fermerë janë të përfshirë në kultivimin e ullirit, megjithatë, shumica e fermave kanë një numër të vogël pemësh ulliri që përdoren kryesisht për konsum vetjak, ku më pak se 1% e tyre kanë më shumë se 0,5 ha ose 5 dynym (tabela 6).

Tabela 8: Fermat e ullirit me orientim tregu (6 dn e lart) për vitin 2017 (dynym)

Sipërfaqja	Numri	%
6 deri në 10 dn	380	54%
11 deri në 20 dn	218	31%
21 deri në 50 dn	78	11%
mbi 51 dn	28	4%
Totali	704	100%

Burimi: Përgatitur nga autorët. Të dhënat bruto nga MBZHR. Shënim: 1 dynym = 0,1 Ha

Për sa i përket përqendrimit rajonal (që përshkruhet në detaje në seksionin e mësipërm), prodhimi i ullirit për vaj ulliri është mjaft i përqendruar në qarqet e Fierit, Vlorës dhe Elbasanit, të cilët së bashku përbëjnë 3/4 e prodhimit total. Në këto qarqe ka edhe një përqendrim të madh të fabrikave/përpunuesve të vajit të ullirit. Për sa i përket ullinjve për tavolinë, kryeson Berati si qarku më i specializuar për prodhimin e tij.

Përpunuesit

Industria e përpunimit të vajit të ullirit përbëhet nga 400 deri në 450 përpunues ulliri, të cilët mund të kategorizohen në katër grupe, (i) përpunues të vegjël lokalë, (ii) përpunues të vegjël modernë, (iii) përpunues të mesëm dhe (iv) përpunues/ambalazhues industrialë.

Përpunues të vegjël lokalë: këtu futet shumica e përpunuesve që gjenden nëpër fshatra. Ekzistojnë rreth 400 të tillë me kapacitet 0,8-1,5 ton/orë. Përpunuesit e vegjël dhe lokalë i përdorin linjat e tyre të përpunimit kryesisht për të ofruar shërbime përpunimi për fermerët dhe për të prodhuar sasi të kufizuara të vajit të ullirit për vete. Mjediset, teknologjia e përpunimit dhe njohuritë teknike të këtyre përpunuesve janë heterogjene: Një pjesë e madhe e përpunimit (për të mos thënë shumica) kryhet në mjedise të papërshtatshme me pajisje të vjetëruara, por ka edhe njësi që operojnë me linja përpunimi të mira të përdorura ose të reja, të cilat i kanë marrë me mbështetjen e projekteve të ndryshme të zhvillimit. Kapacitetet e ruajtjes së vajit në këtë kategori përpunuesish është përgjithësisht i kufizuar dhe cilësia e depozitave është gjithashtu në përgjithësi e dobët. Brenda kësaj kategorie ka edhe *prodhues të vegjël të cilësisë së lartë*: edhe prodhuesit e vegjël modernë përdorin linjat e tyre të përpunimit për t'u ofruar shërbime përpunimi fermerëve, por ata prodhojnë gjithashtu deri në 10 MT vaj ulliri të cilin zakonisht ua shesin direkt familjeve. Përpunuesit e kësaj kategorie zakonisht prodhojnë vaj ulliri të cilësisë së lartë, duke përfshirë vajin e ullirit ekstra të virgjër, madje edhe organik (dy prej tyre gjithashtu eksportojnë sasi të moderuara drejt vendeve si SHBA, Zvicra).

Përpunuesit e mesëm kanë një kapacitet prodhimi më të lartë. Kapaciteti i përpunimit është mbi 1,5 ton/orë - ka rreth 25 fabrika të tilla. Më shumë se 90% e ullirit të përpunuar nga kategoritë e mësipërme të përpunuesve ofrohet si shërbim ndaj palëve të treta (p.sh. fermerët që përpunojnë ullinj të tyre kundrejt një tarife dhe e marrin vetë vajin). Kështu që shumica e vajit të ullirit shitet në rrugë informale. Ata prodhojnë lloje të ndryshme vaji ulliri. Teknologjia e këtyre përpunuesve është e ngjashme me teknologjinë e kategorisë së parë. Shumica (mbi 90%) e kategorive të mësipërme të përpunuesve të vajit të ullirit nuk kanë kapacitete të mirëfillta për ruajtjen e vajit (nuk kanë depozita inoksi për ruajtje, të cilat janë të domosdoshme për të ruajtur cilësinë e vajit të ullirit). Vetëm disa (rreth 5) kanë pajisje (bazë) për paketimin dhe ambalazhimin në shishe - të tjerët i kryejnë këto operacione manualisht.

Përpunuesit/ambalazhuesit industrialë kryesisht prodhojnë dhe shesin vaj ulliri të cilësisë së lartë në masën deri në 80 tonë në vit. Veprimtaria kryesore e biznesit të këtyre kompanive është ambalazhimi

në shishe dhe shitja e vajit të ullirit. Kompanitë më të mëdha kanë edhe linjat e tyre të përpunimit. Sipas intervistave, disa prej këtyre përpunuesve blejnë vaj ulliri me shumicë nga fabrikat e tjera të vajit ose prodhuesit lokalë (shpesh vaj ulliri i cilësisë së ulët i mbajtur stok për disa vite) ose/dhe importojnë vaj ulliri të lirë me cilësi të ulët; megjithatë, ata të gjithë e shesin vajin e ullirit si vaj ulliri të vendit, në disa raste duke përdorur emra lokalë/territorialë, duke keqinformuar konsumatorët për origjinën e vërtetë të vajit të ullirit. Sipas disa përpunuesve të intervistuar të vajit të ullirit, një nga masat kryesore që pritet nga qeveria/politikëbërësit, është që të rregullojë tregtinë e vajit të ullirit, veçanërisht për sa i përket cilësisë dhe falsifikimit të origjinës - kjo masë për zbatimin e ligjit do të nxiste prodhimin vendas të një vaji ulliri me cilësi të lartë dhe do t'i bënte më të nevojshme dhe më të përballueshme investimet e reja në sektor (për të mos përmendur përfitimet që do të ketë konsumatori duke pasur vaj ulliri me cilësi më të lartë në raftet e shitjes me pakicë).

Përpunimi/përdorimi i mbetjeve është i kufizuar - bërësit e ullirit përdoren/shiten tek agroindustria, fermerët e serrave etj., për ngrohje. Nga ato nuk nxirret vaj ulliri. Në përgjithësi, trajtimi aktual i mbetjeve të ullirit nuk përmbush kërkesat/standardet, gjë që nënkupton se mund të nevojiten investime në këtë drejtim, por kjo mund të jetë e realizueshme vetëm pasi të vendoset kuadri ligjor i zbatueshëm. Si përmbledhje, përpunuesit e ullirit kanë investuar në teknologji përpunuese të mirë, por që po vjetërohet (ndaj ekziston nevoja për të investuar në modernizimin e fabrikave ekzistuese), dhe kapacitetet e duhura të ruajtjes dhe ambalazhimi në shishe e etiketimi janë pothuajse inekzistente.

4.2. FLUKSI I ZINXHIRIT TË VLERËS (ZV) DHE KOORDINIMI I KËTIJ ZINXHIRI

Flukset ne zinxhirin e vleres

Flukset e produktit. Siç tregohet në mënyrë skematike në figurën 3, janë katër kanale nëpërmjet të cilëve prodhimi qarkullon nga ferma në përpunim dhe konsum. Aktorët kryesorë sipas kanaleve janë: përpunuesit e vegjël lokalë, përpunuesit e vegjël modernë, përpunuesit e mesëm dhe përpunuesit industrialë (ambalazhuesit). Në rastin e *kanalit të përpunuesve të vegjël lokalë*, përpunuesit kryejnë shërbime për fermerët - ata përpunojnë ullinj të furnizuesve në vaj ulliri kundrejt një tarife me para në dorë (p.sh. 1200 - 1300 Lekë/kv) ose në natyrë (një sasi vaji ulliri e rënë dakord mbahet nga përpunuesi). Këta përpunues nuk kanë lidhje të drejtpërdrejta me shitësit me pakicë ose supermarketet dhe ia shesin vajin e tyre kryesisht direkt familjeve/konsumatorëve. Në rastin e *kanalit të përpunuesve të vegjël modernë*, përpunuesit kryejnë gjithashtu shërbime për fermerët, si në kanalin më lart. Por përpunuesit e vajit të ullirit të cilësisë së lartë tentojnë të shmangin pagesën në natyrë për të ruajtur cilësinë e vajit të tyre të ullirit (duke mos e përzier). Në këtë kanal, pjesa më e madhe e shitjeve bëhet direkt për familjet, kështu që kostot e tyre të marketingut janë shumë të ulëta (në zonat turistike, si në pjesët bregdetare në jug të Shqipërisë, turistët vendas dhe të huaj. Shumë rrallë, nëse ndodh ndonjëherë, ata ia shesin vajin e tyre të ullirit kompanive të ambalazhimit në shishe. Siç u përmend më lart, vaji i ullirit të cilësisë së lartë që eksportohet nga Shqipëria vjen nga kjo kategori përpunuesish. *Kompanitë e mesme* furnizohen me ullinj nga kultivuesit e zonës përreth, nga pjesë të tjera të ndryshme të vendit, por edhe blejnë vaj ulliri nga përpunuesit e vegjël lokalë. Ata ia shesin vajin e tyre të ullirit kompanive më të mëdha të ambalazhimit, restoranteve, konsumatorëve, madje edhe eksportojnë. Disa prej tyre ia shesin vajin e ullirit të ambalazhuar me markën e tyre shitësve me pakicë, supermarketeve dhe restoranteve.

Përpunuesit/ambalazhuesit industrialë e marrin vajin e ullirit nga përpunuesit e vegjël lokalë, përpunuesit e mesëm por edhe direkt nga fermerët (fermerët përpunojnë ullinjtë nëpërmjet shërbimit të përpunuesve dhe e ruajnë vajin e ullirit - në disa raste deri në 3 ose 4 vjet). Ambalazhuesit gjithashtu importojnë sasi të mëdha vaji ulliri. Ata kanë krah pune të organizuar për shitje dhe shpërndajnë direkt për dhjetëra ose qindra dyqane të shitjes me pakicë, tregje të shumicës dhe restorante në të gjithë vendin.. Kështu që kostot e marketingut për këtë kategori përpunuesish janë mjaft të larta.

Flukset financiare. Marrëdhëniet financiare ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve të vajit të ullirit janë të thjeshta - fermerët paguajnë një tarifë financiare për shërbimin që u ofrojnë përpunuesit (ose në natyrë: vaj ulliri). Në rastin kur përpunuesit blejnë ullinjtë (fermerët shesin prodhimin), përpunuesit i paguajnë fermerët brenda një kohe të shkurtër nëpërmjet kredive bankare. Megjithatë, kjo është diçka e rrallë, duke qenë se fenomeni dominues është pagesa në çast për shërbimin e kryer.

Flukset e informacionit. Qarkullimi i informacionit mes aktorëve të zinxhirit është i kufizuar. Vetëm në pak raste, veçanërisht në kanalet e përpunuesve të vegjël modernë, fermerët këshillohen nga përpunuesit, veçanërisht për fazën pas vjeljes - kjo ndodh veçanërisht në rastin e përpunuesve të vajit të ullirit organik. Në përgjithësi, informacioni për tregun është i rrallë.

Koordinimi i zinxhirit të vlerës

Duke qenë se industria e përpunimit të vajit të ullirit funksionon kryesisht si industri shërbimi - përpunuesit ofrojnë shërbime të përpunimit të vajit të ullirit për fermerët dhe transaksionet financiare bëhen kryesisht në pagesa në vend - administrimi (organizimi) i zinxhirit të vlerës mungon. Thënë kjo, disa liderë në zinxhirin e vlerës kanë vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me kultivuesit e ullinjve, siç është prodhuesi i vajit të ullirit organik, z. Vesaf Musai, Shpresa Shkalla, Subashi, Gjikondi, etj (Kutia 1).

Kutia 1: Koordinimi i zinxhirit të vlerës - rasti i certifikimit organik

Musai SHPK është një prodhues i vajit të ullirit me cilësi të lartë, që eksporton vaj ulliri organik direkt drejt SHBA-së dhe tregjeve evropiane. Z. Vesaf Musai (pronar dhe drejtues i Musai SHPK) ka marrëdhënie afatgjata me një grup kryesor fermerësh të mëdhenj (rreth 10 fermerë me nga deri në 10 tonë prodhim secili) - në disa raste edhe mbi bazën e kontratave me shkrim. Z. Musai zakonisht i paguan fermerët kur ata dorëzojnë ullinjtë, por në disa raste ai u ofron financim paraprak për të mbuluar kostot në lidhje me shërbimet që i bëhen ullinjve. Çmimi nuk specifikohet në marrëveshje/kontratë, duke qenë se ata ndjekin çmimet e tregut duke shtuar një pjesë për cilësinë, por marrëveshja specifikon kushte, duke përfshirë kushtin që përpunuesi të blejë prodhimin nga fermeri dhe fermeri t'i shesë prodhimin përpunuesit. Z. Musai monitoron me kujdes ullishtat përpara dhe gjatë vjeljes për t'u siguruar për cilësinë.

Ekziston potenciali për të kultivuar një produkt organik në sektorin e vajit të ullirit. Mbështetja për certifikimin organik duhet të kombinohet me mbështetje për investime për pajisje të thjeshta për vjelje dhe ruajtje, për të mundësuar kalimin me efikasitet të fermerëve drejt prodhimit organik. Mbështetja për certifikimin organik duhet të jepet në bashkëpunim të ngushtë me përpunuesit (siç u përmend më lart, z. Musai monitoron me kujdes ullishtat përpara dhe gjatë vjeljes së ullirit për të garantuar cilësinë). Kështu që angazhimi i përpunuesve në të gjitha fazat e mbështetjes për fermerët është i nevojshëm dhe i dobishëm - dhe investimet e reja të fokusuar te vaji i ullirit organik mund/duhet të marrin në konsideratë qasjen e zinxhirit të vlerës.

Z. Musai ka gjithashtu plane për të përforcuar marrëdhëniet me fermerët, duke i mbështetur ata që të formojnë një kooperativë me qëllimin që të blejnë së bashku rrjetat, kutitë, mjetet e transportit dhe shkundës peme dhe për t'i këshilluar ata në grup.

Burimi: Intervistat e gjysmë strukturuara (Z. Vesaf Musai). Përgatitur nga autorët.

5. PROCESET E TEKNOLOGJISË SË PRODHIMIT

Në vijim paraqitet kalendari i kostove kryesore që lidhen me prodhimin e ullirit. Vjelja është procesi më i kushtueshëm për ullirin, sepse bëhet manualisht.

Tabela 9: Kalendari i kostove kryesore që lidhen me prodhimin e ullirit

Llojet kryesore të shpenzimeve	Jan	Shku	Mar	Pri	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje
1. Krasitja në dimër												
2. Fertilizuesi bazë dhe plotësues*												
3. Vjelja												

Burimi: Vlerësimi i ekspertëve, bazuar në shqyrtimet e dokumentacionit dhe intervistat, përgatitur nga Prof. Dr. Tokli Thomai

Prodhimi/vjelja nis në tetor dhe zgjat deri në dhjetor, ndërsa në bregdetin jugperëndimor deri në janar. Shumica e prodhimit vilet gjatë dhjetëditëshit të tretë të tetorit dhe dhjetëditëshit të dytë të dhjetorit. Shumica e ullinjve për tavolinë në Berat mblidhen gjatë tetorit dhe pjesa tjetër në nëntor. Në Vlorë shumica e prodhimit mblidhet gjatë nëntorit dhe dhjetorit. Edhe në Shqipërinë e Mesme, shumica e ullinjve mblidhen në nëntor dhe pjesa tjetër në tetor dhe dhjetor.

Koha e vjeljes lidhet edhe me subjektin përpunues të vajit: përpunuesit që prodhojnë vaj ulliri ekstra të virgjër preferojnë që ullinjtë të mblidhen shpejt, kur aciditeti është më i ulët. Koha e mbledhjes vendoset gjithashtu në funksion të varietetit. Për shembull, në Vlorë (Novoselë), Frantoia mblidhet në tetor, ndërsa ullinjtë Kalinjoti zakonisht mblidhen në nëntor dhe dhjetor.

Një panoramë më e plotë e kalendarit të vjeljeve paraqitet në tabelën 10 në vijim.

Tabela 10: Kalendari i prodhimit të ullirit sipas qarkut

Rrethi	Tetor			Nëntor			Dhjetor			Dhjetor			Janar		
	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3	1	2	3
Berat															
Durrës															
Elbasan															
Fier															
Gjirokastrë															
Lezhë															
Shkodër															
Tiranë															
Vlorë															
Bregdeti jugperëndimor															

Burimi: DSA (2009), Studim i zinxhirit të vlerës së ullirit dhe vajit të ullirit (raport teknik)

6. ANALIZA SWOT DHE NEVOJAT PËR FINANCIM

6.1. STRATEGJIA BAZUAR NË ANALIZËN SWOT

Strategjia e mëposhtme për analizën SWOT është kryer me qëllim identifikimin e mundësive për financim në sektorin e vajit të ullirit.

Sektori i vajit të ullirit: Strategjia për analizën SWOT

	PIKAT E FORTA (S) (+)	PIKAT E DOBËTA (W) (-)
	Baza e prodhimit me potencial të mirë dhe në fazë zgjerimi	Fragmentimi i bazës së prodhimit të ullirit
	Përmirësimi i bazës së njohurive teknike për përpunimin dhe për disa shërbime teknike	Çmimi tepër i lartë i ullirit të shitur në fermë
	Kultivimi i varieteteve lokale me një potencial shumë të mirë ekonomik	Cilësia e ulët e ullirit për shkak të praktikave të dobëta agronomike, të vjeljes dhe të pasvjeljes.
	Kapacitetet përpunuese të fabrikave të vajit mund të përballojnë një prodhim më të madh pa investime shtesë.	Njohuritë teknike të pamjaftueshme dhe ndërgjegjësimi i papërshtatshëm i prodhuesve për kriteret e cilësisë së tregut.
	Disa fabrika të vogla vaji kanë arritur standarde të larta cilësie, duke fituar çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.	Niveli i lartë i informalitetit në nivel përpunimi.
		Linjat e përpunimit të vajit të ullirit pjesërisht të vjetruara.
		Mungesa e kapaciteteve të ruajtjes së vajit të ullirit në funksion të cilësisë së vajit
		Investimet e pamjaftueshme për ambalazhimin në shishe dhe etiketimin
		Mungesa e rafinerive të vajit të ullirit (olio di sansa)
		Mungesa e investimeve në përpunimin e mbetjeve nga vaji i ullirit
MUNDËSITË (O) (+)	STRATEGJIA PËR S (+) / O (+)	STRATEGJIA PËR W (-) / O (+)
Kërkesa e brendshme e lartë dhe në rritje për vaj ulliri		Mbështetja për mbjelljen/rimbjelljen e ullishtave për ferma relativisht të mëdha
Kërkesat e pakta për eksport për vajin e ullirit me cilësi të lartë		Mbështetja e mbjelljeve (përfundimit të tyre) në ullishtat ekzistuese
Politika e favorshme e qeverisë për sektorin	Mbështetja për mbjelljen/rimbjelljen e varieteteve të ullinjve vendas	Mbështetja për rinovimin e linjave të përpunimit të vajit të ullirit
		Mbështetja për kapacitetet e ruajtjes së vajit të ullirit
		Mbështetja për pajisjet e ambalazhimit në shishe dhe etiketimit
		Mbështetja për projektet e rafinerive
		Mbështetja për projektet e përpunimit të mbetjeve
KËRCËNIMET (T) (-)	STRATEGJIA PËR S (+) / T (-)	STRATEGJIA PËR W (-) / T (-)
Konkurrenca e ashpër nga vendet e tjera mesdhetare (Italia, Greqia dhe Spanja)	Mbështetja e cilësisë së lartë (ekstra i virgjër, organik)	Përmirësimi i teknologjisë së kultivimit

6.2. NEVOJAT PËR FINANCIM

6.2.1. Tendencat për investime dhe nevojat për financim

Tendencat për investime dhe financim

Në nivel ferme, ka pasur një trend mjaft të zhvilluar për të krijuar plantacione të reja me ullinj dhe për të rritur sipërfaqet e mbjella me ullinj. Plantacionet e reja janë ngritur duke përdorur një teknologji mjaft bashkëkohore (nga intervistat në terren). Ky trend është mbështetur fillimisht nga skemat e subvencionimit nga qeveria dhe tani fermerët vazhdojnë të mbjellin edhe pa mbështetjen e qeverisë.

Në nivel përpunimi, janë raportuar raste anekdotike të bizneseve të reja - vlerësimet e ekspertëve konfirmojnë se kapacitetet e instaluar të industrisë së vajit të ullirit mund të përballojë prodhimin aktual dhe të ketë sërish kapacitete të pashfrytëzuara. Investimet në rinovimin e teknologjisë dhe rritjen e kapaciteteve të përshtatshme të ruajtjes së vajit janë të rralla dhe kryesisht bëhen nga përpunuesit e vegjël modernë. Këto lloj investimesh janë financuar nëpërmjet kredive dhe granteve nga qeveria dhe agjencitë donatore.

Nevojat e financimit për investime

Pas strategjisë për analizën SWOT dhe tendencave të investimeve, nevojat e financimit për investime janë përmbledhur në tabelën 11.

Tabela 11: Nevojat e financimit për investime

Lloji i investimit	Fermerët	Përpunuesit	Ambalazhuesit
1. Investimet për mbjelljen ose rimbjelljen e ullishtave, me përparësi për kultivarët lokalë të ullinjve			
2. Mbështetja e mbjelljeve (plotësimi të bimëve) në ullishtat ekzistuese			
3. Sistemet e ujitjes: pajisje dhe makineri për të përmirësuar ujitjen dhe plehërimin nëpërmjet ujitjes, ujitjen me pika dhe ujitjen me pus			
4. Mbështetja për makineri të specializuara për ullishte (shkundës, grirës etj.)			
5. Pajisje për sezonin e vjeljes dhe pas vjeljes, dhe mjedise			
6. Rinovimi i linjave aktuale të përpunimit			
7. Mbështetja për kapacitetet e ruajtjes së vajit të ullirit			
8. Linjat e ambalazhimit në shishe, etiketimit dhe paketimit			
9. Rafinimi i vajit të ullirit			
10. Përpunimi i mbetjeve nga vaji i ullirit			

Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të përmirësuar teknologjinë bujqësore (për plantacionet e reja dhe ullishtat ekzistuese) që Shqipëria të konkurrojë me kosto të ulët importet e vajit të ullirit nga vendet mesdhetare. Kështu që ekzistojnë mundësitë për të financuar plantacionet e reja dhe për të rindërtuar plantacionet e ullishtave ekzistuese.

Ndërkohë që ka pasur investime shumë të mëdha në sektorin e përpunimit të vajit të ullirit, ekziston nevoja për të mbështetur rinovimin e teknologjisë për një pjesë të konsiderueshme të punishteve të përpunimit (që po vjetrohen dhe po dalin jashtë funksionit). Rekomandohet që përparësia në investime të jetë në rinovimin e teknologjisë së kompanive ekzistuese me përvojë në vend të investimeve për krijimin e bizneseve të reja. Investimet në ndërtimin e fabrikave të reja të vajit të ullirit duhet të shqyrtohen me kujdes, duke pasur parasysh faktin që shumica e njësive përpunuese të vajit të ullirit shfrytëzohen më pak se kapacitetet e tyre. Duke qenë se mungon kapaciteti i duhur për ruajtjen e vajit të ullirit (siç tregohet më lart), përpunuesit raportojnë nevojën për të krijuar kapacitetin e ruajtjes për të gjithë industrinë e vajit të ullirit (ku përfshihen shumica e përpunuesve të vajit të ullirit). Investimi në kapacitetet magazinuese të vajit të ullirit është një faktor kryesor që ndikon në cilësinë e vajit të ullirit, së bashku me cilësinë e frutit, teknologjinë e përpunimit dhe njohuritë teknike. Kapaciteti i ambalazhimit në shishe, etiketimit dhe paketimit në fabrikat e vajit dhe tek përpunuesit industrialë përbën gjithashtu një mundësi të rëndësishme për mbështetje nga institucionet financiare dhe qeveria, duke qenë se vetëm disa fabrika të vajit të ullirit i kanë këto pajisje.

Dy projekte të rëndësishme që lidhen me industrinë e përpunimit të mbetjeve në sektorin e ullirit mund të merren gjithashtu në konsideratë, përkatësisht projekti për rafinimin e vajit të ullirit dhe ai për përpunimin e mbetjeve nga vaji i ullirit. Duke qenë se këto janë projekte të mëdha, këshillohet që çdo vendim financiar të paraprihet nga studime të qëndrueshme fizibiliteti.

Kutia 2: Skemat publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare.

Ka dy skema kryesore publike të mbështetjes për bujqësinë shqiptare, përkatësisht Skemat Kombëtare të Mbështetjes (SKM) që jepen çdo vit dhe mbështetja nga BE, si Programi për Zhvillimin Rural, IPARD. Ndërkohë që ky i fundit synon të rrisë konkurrueshmërinë dhe të zbatojë standardet e BE-së (siguria, cilësia dhe mjedisi) dhe synon bizneset më konkurruese, SKM ka politika me shumë objektiva dhe një shtrirje më të gjerë.

Objektivat dhe masat për SKM 2018 janë përmbledhur në vijim:

- Rritja e konkurrueshmërisë duke ofruar mbështetje për investime (mbjellje të reja, investime në agro-përpunim dhe marketing), mbështetja e teknologjive të inovacionit dhe certifikimit dhe sigurimit
- Formalizimi vertikal dhe horizontal dhe formalizimi i biznesit
- Diversifikimi i veprimtarive rurale, duke përfshirë mbështetjen e SME-ve dhe në veçanti mbështetjen për turizmin rural në kombinim me programin e qeverisë për 100 fshatrat turistike.

Ndërkohë që SKM-të tradicionalisht kanë ofruar mbështetje për të përmbushur disa objektiva atë politikës, duke përfshirë rritjen e konkurrencës, kohët e fundit është shtuar vëmendja për arritjen e standardeve të sigurisë së ushqimit, cilësisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Skemat kombëtare të subvencionimit tradicionalisht kanë ndryshuar nga viti në vit (shpesh në mënyrë drastike). Buxheti i alokuar për SKM 2018 është 20 milion euro. Për mbështetjen për investime është e vlefshme edhe skema e ngjashme e politikave të granteve të pjesshme (të paktën 50% mbështetje publike).

Një program tjetër i rëndësishëm është programi i BE-së, IPARD - Programi i Masave për Zhvillimin Rural, i cili mundëson mbështetje për investime që synojnë përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe të BE-së nëpërmjet investimeve të bashkëfinancuara nëpërmjet një granti (p.sh. 50%, megjithatë vlera e saktë varet nga një sërë kriteresh). Për këtë program është miratuar një buxhet në formë granti prej 71 milionë euro nga KE dhe 24 milionë euro nga qeveria shqiptare (75% BE: 25% qeveria shqiptare), kështu që është i disponueshëm një grant për investime prej 94 milionë euro në nivel ferme dhe nivel përpunuesish përgjatë periudhës 2014-2020.

6.2.2. Nevojat për financime për kapital qarkullues

Tendencat e financimeve për kapital qarkullues

Marrëdhëniet ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve zakonisht bazohen në transaksione të çastit me para në dorë ose në natyrë - fermerët paguajnë një tarifë për shërbimin e kryer nga përpunuesit. Raportohet se këto lloj transaksionesh përbëjnë 95% të përpunimit (nga intervistat në terren). Në rastet kur përpunuesit blejnë ullinj për të bërë vajin e tyre të ullirit, disa prej tyre mund të përdorin kredi afatshkurtra për të paguar fermerët që i furnizojnë. Kjo ndodh shpesh për përpunuesit e vegjël modernë, të cilët prodhojnë vaj ulliri me cilësi të lartë.

Nevojat për financime për kapital qarkullues

Në sajë të natyrës së marrëdhënies ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve dhe faktit se vaji i ullirit mund të shitet menjëherë pasi prodhohet, nevoja për kapital qarkullues afatshkurtër (për të paguar fermerët) është më pak e manifestuar se në sektorët e tjerë (si qumështi, molla). Nevoja për kapital qarkullues është e kufizuar në një numër të vogël shoqërisht tregtare që blejnë ullinj dhe kanë vendosur marrëdhënie më të ngushta me fermerët që i furnizojnë.

6.2.3. Financimi i zinxhirit të vlerës

Mundësia për financim në zinxhirin e vlerave të sektorit të vajit të ullirit është e kufizuar për shkak të natyrës së marrëdhënieve (transaksione të çastit, në cash ose në natyrë) ndërmjet fermerëve dhe përpunuesve. Kjo bën dallim nga sektori i qumështit dhe i mollës, ku marrëdhëniet ndërmjet fermerëve dhe konsoliduesve/përpunuesve zakonisht janë më të qëndrueshme. Thënë kjo, institucionet financiare mund të konsiderojnë që të përdorin përpunuesit e vegjël modernë dhe "agjentët" e tyre për të arritur tek fermerët, duke qenë se kjo kategori përpunuesish kanë marrëdhënie më të qëndrueshme me fermerët që i furnizojnë dhe në disa raste i ofrojnë atyre financime paraprake (siç është treguar më lart).

Nevojat për financim kanalizohen në këto drejtime:

- Mbështetja me financim për fermerët që investojnë në rritjen e shërbimeve agro-teknike, instalimeve të ujitjes me pika, mekanike bujqësore, mjete për vjeljen e ullirit.
- Përpunuesit kanë nevojë për investime që lidhen me:
 - Përmisimin e ambjenteve të përpunimit të vajit të ullirit
 - Përmisimin e teknologjisë së përpunimit të vajit të ullirit (dekanter, separator etj.)
 - Investime në depozitim dhe linja ambalazhime dhe etiketimi

7. PËRFUNDIME

Prodhimi i ullirit në Shqipëri është rritur më shpejt se sa prodhimi në botë. Prodhimi i ullirit pothuajse është trefishuar (në rreth 100 000 - 120 000 tonë gjatë 2 viteve të kaluara) krahasuar me fillimin e viteve 2000, por megjithatë, ka luhatje të mëdha nga viti në vit. Edhe prodhimi i vajit të ullirit është rritur ndjeshëm, duke arritur në 20 000 tonë vitin e kaluar (2017) - duke qenë se shumica e ullinjve përdoren për vaj ulliri, rritja e prodhimit të vajit të ullirit ka ndjekur tendencën rritëse të prodhimit të ullinjve të papërpunuar. Prodhimi është ende shumë i fragmentizuar dhe rendimenti është mjaft i ulët, pasi fermerët nuk kryejnë shërbimet e duhura agronomike për pemët.

Vaji i ullirit kryesisht ka si destinacion tregun vendas - por ka ende mundësi të mëdha për të plotësuar kërkesën në tregun vendas duke qenë se konsumi i dukshëm i vajit të ullirit është i ulët krahasuar me vendet e tjera mesdhetare që prodhojnë vaj ulliri. Fragmentizimi i lartë dhe kostot e larta të prodhimit nënkuptojnë se Shqipëria ka një disavantazh në kosto për sa i përket potencialit për të eksportuar, po të merret në konsideratë se vendet fqinje të Shqipërisë janë lider në prodhimin e ullirit dhe vajit të ullirit. Thënë kjo, Shqipëria mund të eksportojë vaj ulliri të cilësisë së lartë me certifikim organik. Kjo aktualisht ndodh në një shkallë shumë të ulët.

Prodhimi i ullirit është rritur në sajë të kushteve të ofertës (klima, dheu dhe tradita), por ai gjithashtu është subvencionuar nga qeveria, e cila në fillim i ka dhënë subvencione për krijimin e një baze përpunuese relativisht bashkëkohore dhe më pas, pas vitit 2007, për zgjerimin e bazës së prodhimit (kultivimit të ri), që ka ardhur pjesërisht për shkak të mbështetjes me subvencione.

Prodhimi i brendshëm po përmirësohet për sa i përket cilësisë dhe sasisë, por ai vuan nga çmimi ekstremisht i lartë i ullirit të papërpunuar. Prodhimi është ende shumë i fragmentizuar dhe rendimenti është mjaft i ulët, pasi fermerët nuk kryejnë shërbimet e duhura agronomike për pemët.

Shqipëria ka avantazhe konkurruese të kufizuara në eksportin e vajit të ullirit për shkak të kostos së lartë të prodhimit, vëllimeve të ulëta dhe standardeve të diskutueshme të cilësisë. Ndërkohë që pak kompani tregtare kanë arritur të gjejnë tregun "niche" të tyre dhe të eksportojnë me cilësi të lartë, aktorët kryesorë të industrisë së vajit të ullirit në Shqipëri duhet të kenë si objektiv tregun e brendshëm, ku ka mundësi të konsiderueshme për të plotësuar kërkesën në rritje dhe ende të paplotësuar - gjithashtu, ekziston potenciali që konsumi i brendshëm (kërkesa) të rritet gjatë viteve në vazhdim (me rritjen e mëtejshme të të ardhurave dhe ndërgjegjësimit të konsumatorit).

Tregu për ushqimin organik në Shqipëri është ende i vogël, por preferenca e konsumatorëve për ushqim organik paraqet një potencial për zhvillimin e tregut në përgjithësi dhe për vajin e ullirit në veçanti, i cili mund të zhvillohet në të ardhmen me rritjen e të ardhurave dhe ndërgjegjësimit rreth ushqimeve organike (vajin e ullirit).

Sipas disa përpunuesve të intervistuar të vajit të ullirit, një nga masat kryesore që pritet nga qeveria/politikëbërësit, është që të rregullojë tregtinë e vajit të ullirit, veçanërisht për sa i përket cilësisë dhe falsifikimit të origjinës - kjo masë për zbatimin e ligjit do të nxiste prodhimin vendas të një vaji ulliri me cilësi të lartë dhe do t'i bënte më të nevojshme dhe më të përballueshme investimet e reja në sektor (për të mos përmendur përfitimet që do të ketë konsumatori duke pasur vaj ulliri me cilësi më të lartë në raftet e shitjes me pakicë).

Shumica e fermerëve janë fermerë të vegjël. Ata preferojnë të përdorin fabrikat e vajit si ofrues shërbimi. Ata paguajnë një tarifë për përpunimin e ullirit dhe në fund marrin vajin. Cilësia e vajit është e dobët për shkak të praktikave të papërshtatshme pas vjeljes dhe të kushteve të ruajtjes.

Industria e përpunimit kryesisht është e ndarë në katër segmente: i) ambalazhuesit e mesëm dhe të mëdhenj, të cilët prodhojnë pak vaj ulliri dhe pjesën tjetër e blejnë me shumicë; këta janë prodhuesit e vajit të ullirit të ambalazhuar në shishe që shitet në shumicën e dyqaneve, ii) përpunuesit e mesëm, të cilët në përgjithësi i shesin me shumicë ambalazhuesve, edhe pse disa prej tyre ambalazhojnë vetë, iii) prodhuesit e vegjël të vajit të ullirit me cilësi të lartë dhe; iv) përpunuesit e vegjël, të ardhurat kryesore të të cilëve vijnë nga përpunimi i ullirit të fermerëve, ata gjithashtu përpunojnë dhe shesin, në masë të vogël, vajin e tyre të ullirit. Një pjesë e madhe e përpunimit (për të mos thënë shumica) kryhet në mjedise të papërshtatshme me pajisje të vjetruara, por ka edhe njësi që operojnë me linja përpunimi të mira të përdorura ose të reja, të cilat i kanë marrë me mbështetjen e projekteve të ndryshme të zhvillimit. Përpunimi/përdorimi i mbetjeve është i kufizuar - bërsitë e ullirit përdoren/shiten tek agroindustria, fermerët e serrave etj., për ngrohje. Nga ato nuk nxirret vaj ulliri. Në përgjithësi, trajtimi aktual i mbetjeve të ullirit nuk përmbush kërkesat/standardet, gjë që nënkupton se mund të nevojiten investime në këtë drejtim, por kjo mund të jetë e realizueshme vetëm pasi të vendoset kuadri ligjor i zbatueshëm.

Studimi aktual informon institucionet financiare dhe palë të tjera të interesuara për mbështetjen e këtij sektori për mundësitë kryesore për të financuar këtë sektor. Investimi kryesor që duhet marrë në konsideratë është krijimi i plantacioneve të reja me ullinj, veçanërisht duke përdorur kultivarët autoktonë dhe duke përmirësuar teknologjinë e ullishtave ekzistuese; investimet në pajisje për sezonin e vjeljes dhe pas vjeljes dhe në mjedise; rinovimi i linjave aktuale të përpunimit; mbështetja e kapaciteteve për ruajtjen e vajit të ullirit; mbështetja për linjat e ambalazhimit në shishe dhe etiketimit dhe mbështetja e projekteve të mëdha si rafinimi i vajit të ullirit dhe përpunimi i mbetjeve të vajit të ullirit. Duke qenë se Shqipëria ka kushte mjaft të mira, institucionet financiare mund të shqyrtojnë financimin për investime në skemat e cilësisë si treguesit gjeografikë (TGJ), emërtimi i origjinës së mbrojtur (EOM) dhe prodhimi organik. Kjo mund të jetë një alternativë e eksportit me kosto të ulët, siç përmendet më lart, eksport i cili nuk është alternativë e realizueshme për Shqipërinë.

Sektori i ullirit konsiderohet si sektor me përparësi për qeverinë shqiptare - sektori është përfshirë në skemat e mbështetjes financiare publike, duke përfshirë skemat e fundit të mbështetjes. Politika aktuale e granteve të pjesshme ka implikime të rëndësishme për institucionet financiare - ata kanë mundësi për të financuar paraprakisht dhe në mënyrë të plotë investimet dhe për të bashkëfinancuar investimet (p.sh. deri në 50% për pjesën që nuk mbulohet nga subvencionet ose kursimet vetjake).

8. BIBLIOGRAFIA

Chan-Halbrendt, C., Zhllima, E., Sisor, G., Imami, D., & Leonetti, L. (2010). Consumer preferences for olive oil in Tirana, Albania. *International Food and Agribusiness Management Review*, 13(3).

EC (2017), EU Agricultural Outlook for the Agricultural Markets and Income 2017-2030

Eurostat (2018), <http://ec.europa.eu/eurostat>

FAOSTAT (2018) Baza e të dhënave gjendet në <http://www.fao.org/faostat/en/>?

QSH. 2018. Vendim Nr. 72, datë 7.2.2018, "Për përcaktimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018".

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia Agro-alimentare*.

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., Cela, A., & Sokoli, O. (2015). Consumer preferences for typical local products in Albania. *Economia agro-alimentare*.

Imami, D., Skreli, E., Zhllima, E., & Chan, C. (2017). Consumer attitudes towards organic food in the Western Balkans-the case of Albania. *ECONOMIA AGRO-ALIMENTARE*.

Leoneti, L., Imami, D., Stafanllari, A., and Zhllima, E. (2009). The olive and olive oil value chain in Albania. Development Solutions Associates

Vjetari i statistikave MBUMK (2010)

UNSTAT (2018), Baza e të dhënave për tregtinë <https://comtrade.un.org/data/>

9. SHTOJCAT

Tabela 12: Shpërndarja e fermave të mëdha sipas qarkut

Qarku	6 deri në 10 dn	11 deri në 20 dn	21 deri në 50 dn	Mbi 51 dn
Berat	171	96	22	4
Durrës	22	26	6	1
Elbasan	44	3	4	1
Fier	3	5	9	4
Gjirokastër	3	9	1	2
Lezhë	36	17	11	1
Shkodër	6	6	3	10
Tiranë	33	20	13	2
Vlorë	62	36	9	3
Totali	380	218	78	28

Tabela 13: Tendencat e kultivimit të ullirit në botë (000 ha)

Shteti	2000	2005	2010	2014	2015	2016
Shqipëri	33	29	34	40	42	39
Mali i Zi	:	:	0,1	0,1	0,1	0,1
BE	4.644	4.825	4.862	4.891	4.837	5.029
Bota	8.352	9.189	9.899	10.171	10.278	10.650
Evropë	4.678	4.847	4.889	4.926	4.874	5.063
Evropa Jugore	4.662	4.829	4.873	4.909	4.857	5.046

Burimi: FAOSTAT

Siç tregohet në Tabelën 11 në vijim, prodhimtaria e ullirit në Shqipëri për vitin 2016 (2,5 tonë/ha) mund të krahasohet me atë në vendet e tjera ose grupet e vendeve të tjera.

Tabela 14: Tendencat e prodhimtarisë së ullirit në botë (tonë/ha)

Shteti	2000	2005	2010	2014	2015	2016
Shqipëri	1,1	1,1	2,1	2,5	2,3	2,5
Mali i Zi	:	:	8,8	3,1	2,7	2,8
BE	2,3	2,2	2,8	2,0	2,3	2,3
Bota	1,9	1,7	2,1	1,6	1,9	1,8
Evropë	2,3	2,2	2,8	2,0	2,3	2,3
Evropa Jugore	2,3	2,2	2,8	2,0	2,3	2,3

Burimi: FAOSTAT

Tabela 15: Konsumi i dukshëm i vajit të ullirit në Shqipëri dhe në vende dhe rajone të tjera në botë (kg/frymë)

Shteti	2000	2005	2010	2011	2012	2013
Shqipëri	0,6	0,5	0,6	0,6	0,7	0,6
Mali i Zi	:	:	0,5	0,4	0,5	0,5
Serbi	:	:	0,1	0,1	0,1	0,1
Maqedoni	1,0	1,1	0,8	0,8	0,9	0,9
Bota	0,4	0,4	0,4	0,4	0,4	0,4
BE	3,3	3,3	3,4	3,5	3,4	3,3
Evropë	2,4	2,3	2,4	2,5	2,4	2,3
Evropa Lindore	0,0	0,1	0,2	0,2	0,2	0,2
Evropa Jugore	10,2	9,3	9,3	9,5	9,0	8,7
Evropa Perëndimore	0,9	1,0	1,1	1,2	1,2	1,2

Burimi: FAOSTAT



Tiranë, 2019